



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:282827

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05421909

**E.nr.772/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve: V.T., V.Xh., F.S., E.T. dhe I.I., të cilët i përfaqëson av Qëndrim Reçica nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 07.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.772/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.772/22, të datës 01.09.2022, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2021:282827, të datës 28.03.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 12.12.2022 dhe 07.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, t'i transferoj shumat e mjeteve prej 2,677.40 euro dhe 264.33 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**E.nr.772/22, më datë 07.03.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**